



Примено: E prapuar:	28.02.2022		
Орг. единица Njësia Org.	Број Numër	Прилог Shtojcë	Вредност Vlerë
08	969/1		



Република Северна Македонија
ОПЕРАТИВНО-ТЕХНИЧКА АГЕНЦИЈА

Republika e Maqedonisë së Veriut
AGJENCIA-TEKNIKE OPERATIVE



Republic of North Macedonia
OPERATIONAL-TECHNICAL AGENCY

ДО:/ DREJTUAR:

Собрание на Република Северна Македонија/ Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut
Бул. 11 Октомври 10, 1000 Скопје/ Bul. 11 Tetori 10, 1000 Shkup

ПРЕДМЕТ:/LËNDA:

Годишен извештај за работењето на Оперативно-техничката агенција за 2021 година
Raport vjetor për punën e Agjensisë Teknike Operative për vitin 2021

Почитуван претседател на Собранието на Република Северна Македонија,
I nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut,

Во прилог на овој допис, а врз основа на член 7 од Законот за Оперативно-техничка агенција („Службен весник на Република Македонија“ бр. 71/18 и „Службен весник на Република Северна Македонија“ бр. 98/19) до Собранието на Република Северна Македонија го доставувам за разгледување Годишниот извештај за работењето на ОТА за 2021 година заведен под број 01-149/1 од 25.02.2022 година.

Нë shtojcë të kësaj shkrese, ndërsa në bazë të nenit 7 të Ligjit për Agjensinë Teknike Operative (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 71/18, dhe “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 98/19), në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut e dorëzohј për shqyrtim Raportin vjetor për punën e ATO-s për vitin 2021 i arkivuar me numër 01-149/1 nga 25.02.2022.

За сите потребни прашања и образложенија останувам на располагање.

Për të gjitha pyetjet dhe arsyetimet jam në dispozicion.

Со почит,
Me respekt,

ОПЕРАТИВНО ТЕХНИЧКА АГЕНЦИЈА
AGJENSIA TEKNIKE OPERATIVE

ДИРЕКТОР,
DREJTORI,

Зоран Ангеловски
Zoran Angellovski



Прилог: Годишен извештај за работењето на ОТА за 2021 година број 01-149/1 од 25.02.2022
Shtojcë: Raport vjetor për punën e ATO-s për vitin 2021 me numër arkiv 01-149/1 nga 25.02.2022

Изработено во два (2) примерока и доставено до:/Punuar në 2 (dy) ekzemplarë origjinal dhe parashtruar te:

- писарница на ОТА/ Zyra e prtokollimit të ATO-s
- Собрание на РСМ/ Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut

Republika e Maqedonisë së Veriut
AGJENCIA TEKNIKE OPERATIVE

**RAPORT VJETOR
PËR PUNËN E AGJENCISË TEKNIKE OPERATIVE SHKUP
PËR VITIN 2021**

Shkup,
shkurt, 2022

Republika e Maqedonisë së Veriut

AGJENCIA TEKNIKE OPERATIVE

Në bazë të nenit 7 të Ligjit për Agjencinë Teknike Operative (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 71/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 98/19 – në tekstin e mëtejshëm: LATO), drejtori i Agjencisë Teknike Operative Shkup (në tekstin e mëtejshëm - ATO), e miratoi dhe e dorëzoi për shqyrtim në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut këtë:

RAPORT VJETOR PËR PUNËN E AGJENCISË TEKNIKE OPERATIVE SHKUP PËR VITIN 2021

I. HYRJE

Agjencia Teknike Operative është organ i pavarur dhe i mëvetësishëm shtetëror, e themeluar me Ligjin për Agjencinë Teknike Operative, me të cilin ligj përveç themelimit të ATO-së, rregullohen edhe kompetencat, udhëheqja, të drejtat dhe obligimet e marrëdhënies së punës së punonjësve në ATO, mbikëqyrja profesionale dhe financimi i ATO-së.

Në pajtim me dispozitat ligjore, drejtori i ATO-së e dorëzon për shqyrtim në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut këtë raport vjetor për punën e ATO-së për vitin paraprak 2021.

II. NUMRI I KOMUNIKIMEVE TË AKTIVIZUARA PËR NEVOJAT E ORGANEVE TË AUTORIZUARA

Gjatë vitit 2021, për nevojat e organeve të autorizuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ATO-ja teknikisht ndërmjetësoi në:

- 471 aktivizime të reja të masës ndjekja e komunikimeve dhe
- 342 vazhdimet të masës ndjekja e komunikimeve.

III. NUMRI I KOMUNIKIMEVE TË AKTIVIZUARA PËR ÇDO ORGAN TË AUTORIZUAR VEÇMAS

Nga numri i përgjithshëm i theksuar i 471 aktivizimeve të reja të masës ndjekja e komunikimeve me ndërmjetësimin teknik të ATO-së në vitin 2021:

- 292 aktivizime të masës ndjekja e komunikimeve ishin për nevojat e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe
- 12 aktivizime të masës ndjekja e komunikimeve ishin për nevojat e Prokurorisë Publike.

Nga 342 vazhdimet e theksuara të masës ndjekja e komunikimeve me ndërmjetësimin teknik të ATO-së në vitin 2021:

- 172 vazhdime të masës ndjekja e komunikimeve ishin për nevojat e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

IV. GJENDJA DHE GJETJET E KONSTATUARA GJATË MBIKËQYRJEVE TË KRYERA PROFESIONALE NGA ATO-JA PËR PUNËN E OPERATORËVE

Gjatë vitit 2021 në kuadër të aktiviteteve rrjedhëse për kryerjen e kompetencave ligjore, Agjencia Teknike Operative në vazhdimësi zbatoi mbikëqyrje të planifikuara dhe të jashtëzakonshme në punën e operatorëve lidhur me përmbushjen e kushteve teknike dhe masave dhe standardeve të zbatuara të parashikuara me rregullativën në fuqi gjatë ndjekjes së komunikimeve elektronike.

Në vitin 2021 u realizua projekti për plotësimin e sistemit për ndjekjen e komunikimeve, përkatësisht integrimi i të gjithë servisëve (komunikimi i të folurit dhe i të dhënave).

Aktivitetet që u zhvilluan gjatë realizimit të këtij projekti mundësuan kontrollimin sistematik të gjendjeve për elementët e rrjetit që janë pjesë e procesit të ndjekjes së komunikimeve. Në kuadër të aktiviteteve të përmendura, personat kompetentë të ATO-së patën mundësinë ta inspektojnë infrastrukturën e disponueshme, përmbushjen e kushteve teknike dhe masat e zbatuara të parashikuara me ligj dhe aktet nënligjore. Në pajtim me të konstatuarën, u janë dorëzuar kërkesa operatorëve për të vepruar dhe mundësuar kushteve teknike që i imponon progresi teknologjik në fushën e telekomunikimeve dhe ligjeve referente.

Në pajtim me obligimet e parashikuara ligjore dhe Planin për kryerjen e mbikëqyrjes nga Komisioni për Kryerjen e Mbikëqyrjes Profesionale të Operatorëve në ATO, gjatë vitit 2021 janë zbatuar katër (4) mbikëqyrje të rregullta profesionale tek operatorët e telekomunikimeve: Telekom i Maqedonisë, A1 Maqedoni, Neotel dhe Telekabel. Lënda e mbikëqyrjes ishte përcaktuar me qëllim të konstatimit të gjendjeve të operatorëve, përdorimit të pajisjes teknike dhe përçuesve të komunikimit që shërbejnë për lidhjen e ATO-së dhe operatorëve, si dhe planeve për zhvillimin dhe zbatimin e teknologjive të reja që do të kishin impakt mbi sigurimin e kushteve të domosdoshme me të cilat mundësohet ndjekja e komunikimeve me ndërmjetësimin e ATO-së. Raportet përkatëse nga mbikëqyrjet e zbatuara u janë dorëzuar operatorëve, Komisionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Masave për Ndjekjen e Komunikimeve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Agjencisë së Komunikimeve Elektronike.

V. NUMRI I PROCEDURAVE TË ZBATUARA DISIPLINORE PËR PUNONJËSIT NË ATO

Gjatë vitit 2021 në ATO nuk ishin zbatuar procedura disiplinore.

VI. PUNA FINANCIARE E ATO-SË

Financimi

Në pajtim me nenin 33 të Ligjit për Agjencinë Teknike Operative (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 71/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 98/19 – në tekstin e mëtejme: LATO), mjetet për rroga, kompensimet dhe shtesat e rrogës, për punën, avancimin, modernizimin dhe pajisjen e ATO-së, si dhe për stimulimin e punonjësve në ATO, të parashikuara me planin financiar vjetor të ATO-së, sigurohen:

- nga kompensimet e Agjencisë së Komunikimeve Elektronike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në pajtim me nenin 29-a të Ligjit për komunikime elektronike (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 39/14, 188/14, 44/15, 193/15, 11/18, 21/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 98/19, 153/19 dhe 92/21 – në tekstin e mëtejme: LKE), në bazë të planit financiar vjetor të miratuar paraprakisht të ATO-së nga Komisioni për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Masave për Ndjekjen e Komunikimeve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut (a.q. shpenzimet nga aktivitetet e vetëfinancuara)

- dhe nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut (a.q. shpenzimet nga buxheti themelor).

Buxheti i ATO-së për vitin 2021

Në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 307/2020) Agjencisë Teknike Operative i ishte siguruar buxheti për vitin 2021 në shumë prej 139.725 mijë denarë, prej të cilave si shpenzime nga buxheti themelor ishte parashikuar shuma prej 53.725 mijë denarë, ndërsa si shpenzime nga aktivitetet e vetëfinancuara (kompensimet e AKE-së në pajtim me LKE-në) ishte parashikuar shuma prej 86.000 mijë denarë.

Në mënyrë plotësuese, pjesa e mbetur e mjeteve të shpenzimeve nga aktivitetet e vetëfinancuara sipas ekstraktit të fundit për vitin 2020 në shumën e disponueshme prej 49.082.632,00 denarë, në pajtim me nenin 37-b, paragrafi 6 të Ligjit për buxhete (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 64/05, 04/08, 103/08, 156/09, 95/10, 180/11, 171/12, 192/15 dhe 167/16 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 151/21), në fund të vitit fiskal transferohet në vitin e ardhshëm 2021. Në këtë kuptim, Ministria e Financave miratoi zgjerimin e Buxhetit të ATO-së për vitin 2021 për shumën e theksuar, më saktë zgjerimin e shpenzimeve nga aktivitetet e vetëfinancuara (kompensimet e AKE-së në pajtim me LKE-në) për vitin 2021 në shumë të përgjithshme prej 116.033 mijë denarë.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe institucionet dhe organet e tjera relevante në mënyrë përkatëse me zgjidhjen ligjore, të sigurt dhe efikase për avancimin dhe digjitalizimin e procesit për zbatimin e masës për ndjekjen e komunikimeve elektronike, si dhe hetimet dhe analizat e zbatuara dhe projektin e hartuar dhe të miratuar – zgjidhja teknike për digjitalizimin e institucioneve të përfshira në proces, Agjencia e Komunikimeve Elektronike (AKE) siguroi donacion, me ç’rast Agjencia Teknike Operative ishte emëruar për koordinimin e projektit. Për këtë qëllim, Ministria e

Financave me Leje bëri zgjerimin e buxhetit të ATO-së në llogari të veçantë (të donacionit) për dedikimin e theksuar në shumën prej 45.000 mijë denarë (a.q. shpenzimet nga donacionet).

Pas zgjerimeve të theksuara, Buxheti i përgjithshëm i miratuar i Agjencisë Teknike Operative për vitin 2021 ishte 214.758 mijë denarë.

Me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021 ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 171/21) Buxheti i Agjencisë Teknike Operative për vitin 2021 ishte zvogëluar në pjesën e shpenzimeve nga buxheti themelor për shumën prej 7.740 mijë denarë, me ç'rast Buxheti i përgjithshëm i ATO-së ishte miratuar në shumën prej 207.018 mijë denarë.

Realizimi i buxhetit të ATO-së për vitin 2021

Nga gjithsej mjetet e miratuara në Buxhet, nga Agjencia Teknike Operative në vitin 2021 ishin realizuar mjete në shumë të përgjithshme prej 144.675.148,00, si:

- nga shpenzimet e buxhetit themelor në vitin 2021 janë realizuar 44.479.324,00 denarë, që është 96,73% të shumës së përgjithshme të mjeteve të miratuara;

- nga shpenzimet e aktiviteteve të vetëfinancuara në vitin 2021 janë realizuar 69.347.490,00 denarë, që është 59,77% të shumës së përgjithshme të mjeteve të miratuara. Pjesa e porealizuar e mjeteve në pajtim me nenin 37-b, paragrafi 6 të Ligjit për buxhete ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 64/05, 04/08, 103/08, 156/09, 95/10, 180/11, 171/12, 192/15 dhe 167/16 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 151/21), në fund të vitit fiskal transferohen në vitin e ardhshëm 2022;

- nga shpenzimet nga donacioni janë realizuar 30.848.334,00 denarë, që është 68,55% të shumës së përgjithshme të parashikuar, ndërsa në pajtim me dinamikën e parashikuar të projektit. Pjesa e mbetur e mjeteve në shumën prej 14.151.666,00 denarë në pajtim me nenin 37-b, paragrafi 6 të Ligjit për buxhete ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 64/05, 04/08, 103/08, 156/09, 95/10, 180/11, 171/12, 192/15 dhe 167/16 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 151/21), në fund të vitit fiskal transferohen në vitin e ardhshëm 2022, për shkak që Ministria e Financave në bazë të kërkesës për zgjerim bëri zgjerimin e Buxhetit të ATO-së për vitin 2022 në llogarinë e dedikuar për donacion për shumën e njëjtë.

Realizimi i mjeteve të ATO-së për vitin 2021 të ndara sipas zërave është si në vijim:

Numri rendor	Zëri	Shumat e realizuara sipas zërave në denarë
1.	401-20	20.468.880,00
2.	402-20	9.756.642,00
3.	404-20	225.000,00
4.	420-20	184.356,00
5.	421-20	1.838.994,00
6.	423-20	142.856,00

7.	424-20	43.480.878,00
8.	425-20	8.924.507,00
9.	426-20	879.064,00
10.	464-20	81.304,00
11.	480-20	18.795.389,00
12.	481-20	0,00
13.	483-20	0,00
14.	485-20	39.897.278,00
GJITHSEJ		144.675.148,00

Duke pasur parasysh se Agjencia Teknike Operative me punë filloi në nëntor 2018, duke u vendosur krejtësisht si institucion i ri, duke e filluar veprimtarinë e saj nga fillimi në të gjitha aspektet dhe duke iu nënshtruar një sërë sfidash, me realizimin e buxhetit të miratuar në vitin 2021 është arritur progres i rëndësishëm në realizimin e prioriteteve dhe qëllimeve strategjike të Agjencisë Teknike Operative, të tilla si: avancimi i sistemeve dhe forcimi i sigurisë së infrastrukturës së TI-së, përmirësimi i funksionaliteteve të sistemit të komunikimit midis të gjithë pjesëmarrësve në procesin e ndjekjes ligjore të komunikimeve elektronike dhe forcimi i kapaciteteve organizative të ATO-së.

Si një nga sfidat me të cilën fillon të përballet ATO-ja është zgjidhja e përhershme e çështjes për akomodimin dhe përshtatjen e saj hapësinore, me ç'rast prolongimet administrative të zgjidhjes së çështjeve relevante ndikuan edhe në (mos)realizimin e zërave të caktuar të Buxhetit të ATO-së, edhe pse për të ishin planifikuar dhe siguruar mjete (kjo veçanërisht u referohet zërave 481 dhe 483, ndërsa ndikim edhe në realizimin e zërave 421 dhe 425).

VII. PUBLIKIMI

Ky Raport vjetor për punën e ATO-së për vitin 2021 dorëzohet për shqyrtim në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, më së voni në fund të shkurtit 2022 dhe ai publikohet në vend të dukshëm në faqen e internetit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

AGJENCIA TEKNIKE OPERATIVE SHKUP

DREJTORI,

Zoran Angellovski